



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.105/2024

Datë: 23 prill 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në takimin 325, të mbajtur me datë 23 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Vazhdohen kontratat e punës për gjashtëmbëdhjetë (16) zyrtarët e angazhuar paraprakisht në gjykata dhe Sekretariat me mbështetjen e projektit të UNDP-së, sipas listës së bashkangjitur për tre (3) muaj respektivisht nga data 1 maj 2024 deri më 31 korrik 2024.
- II. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KGJK-së të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për nënshkrimin e kontratave.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 23 prill 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e 325-të, të datës 23 prill 2024, ka shqyrtuar mundësinë e vazhimit të kontratave të punës për 16 (gjashtëmbëdhjetë) zyrtarët e angazhuar paraprakisht me mbështetjen e projektit të UNDP-së, në realizimin e Planit strategjik për sistematizimin, digjitalizimin dhe automatizimin e arkivave për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Në situatën aktuale, donatori ka njoftuar se nuk ka mundësi të mbuloj financimin e mëtutjeshëm të pagave të tyre andaj nisur nga fakti se kontratat e punës së tyre skadojnë dhe me qëllim që të ruaj kontinuitetin e punës deri më tani, KGJK vendosi të bëjë financimin e pagave të tyre për muajin maj, qershor dhe korrik 2024.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe Arkivit